



Pranimar / Dorezuar Pamiheno / Prodato Received / Delivered	19-04-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2232/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.263/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1146/20 të datës 27.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.130/2020 të datës 21.04.2020 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat me adresë banimi kundër organit të punësimi-Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 19.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.130/2020 e datës 21.04.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Ref.54/2020 i datës 20.02.2020 i Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 21.04.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.54/2020 të datës 20.02.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.04.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (me tej MPJD), ndërsa kjo e fundit me datë 18.05.2020 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Këshilli më datë 04.06.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 1027/2020, ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e tij të datës 21.04.2020 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 17.01.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1146/20, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së e datës 04.06.2020 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 21.04.2020.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.130/2020 e datës 21.04.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 23.03.2020; Vendimin Nr. Ref.54/2020 të datës 20.02.2020; Vendimin Nr.ref 801/2018 të datës 10.09.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 929/2020 të datës 18.05.2020; Ankesën me numër protokollit 659 të datës 19.03.2020 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Autorizimi e datës 04.03.2020; Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm e pa nënshkruar; Aktgjykimin A.nr.1146/20 të datës 27.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 04.06.2020 dhe Përgjigje në ankesën me numër protokollit 659 të datës 10.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankuesit

**SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi sipas Vendimit më numër Ref.801/2018 të datës 10.09.2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme ishte emëruar Konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Podgoricë-Malit të Zi, me mandat katër (4) vjeçar duke filluar nga data 15.10.2018. Ndërsa më datë 20.02.2020, Ministri i MPJD me Vendimin Nr.Ref.54/2020 ka shfuqizuar vendimin me numër Ref.801/2018 të datës 10.09.2018, me arsyetimin se ankuesi është emëruar në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës duke obliguar të njëjtin që ta liroj detyrën e Konsullit në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.Ref.54/2020 të datës 20.02.2020, me datë 10.03.2020 kishte parashtruar ankesë me numër protokollit 659 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa ky i fundit përmes shkresës me numër 24/2020 të datës 23.03.2020 i është përgjigjur ankuesit se nuk ka mandat dhe përgjegjësi ta shqyrtojë ankesën e ankuesi.

Ankuesi, pas njoftimit të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 23.03.2020,



brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se Vendimi Nr.ref.54/2020 i datës 20.02.2020 është nxjerr me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Kosovës i zbatueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 4 paragrafi 1 të njëjtit ligj ku parashihet se: "... 4. Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: ..... të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave.* Ndërsa Ligji Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-207, konkretisht neni 8 përcakton se: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se përveç të emëruarave politik, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civil dhe së të njëjtit i nënshtrohen dispozitave të ligjeve të veçanta dhe Ligjit për Shërbim Civil të Kosovës.*

Po ashtu, edhe Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me Nr.ref:AGJ 1583/2020, përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë.*

Kolegji i Këshillit në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, ka analizuar dispozitat e nenit 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm ku shprehimisht theksohet se: *Pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, në pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe legjislacionin në fuqi, si dhe Rregulloren Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm konkretisht nenin 6 me të cilin është përcaktuar se: 1. Ashtu siç është përcaktuar në nenin 19 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, anëtarët e Shërbimit të Jashtëm duhet të plotësojnë kushtet e dhëna më poshtë në mënyrë që të pranohen në Shërbimin e Jashtëm: ....1.8. Të kenë kaluar provimin pranues të organizuar në bazë të procedurave të përcaktuara me aktin nënligjor të Ministrisë, ndërlidhur me këtë të fundit, Udhëzimi Administrativ 02/2012 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.3/2009 për Procedurat e Emërimit të kandidatëve për nëpunës të misionit diplomatik, ka rregulluar hollësisht procedurën e pranimit në shërbim të jashtëm dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar së pranimi në shërbim të jashtëm bëhet përmes konkursit publik të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme, pas kalimit me sukses të vlerësimit me shkrim dhe me gojë nga ana e Komisionit Përgjegjës, i cili harton një listë të kandidatëve të vlerësuar me së shumti pikë, duke rekomanduar tre (3) kandidatë për një pozitë të lirë, që me pastaj lista në fjalë përmes Sekretarit të Përhershëm i përcillet Ministrit për emërim përfundimtar.*

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesi është emëruar anëtar i shërbimit të jashtëm sipas Vendimit më numër Ref.801/2018 të datës 10.09.2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mirëpo, me asnjë provë nuk dëshmohet se ankuesi i është nënshtruar procedurës së rekrutimi për praninë në shërbim të jashtëm ashtu siç përcaktohet me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin si dhe nenin 6 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, e në këtë kuptim edhe në ankesën e pashtuar në Këshill, ankuesi në asnjë rast nuk ka pohuar se i njëjti është emëruar sipas procedurës së konkurrimit dhe përzgjedhjes, e po ashtu ankuesi nuk ka ofruar ndonjë akt për krijimin e marrëdhënies së punës me Ministrinë e Punëve të Jashtme, kështu që mbi këto arsye Kolegji vlerëson së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit së vendimi i goditur me ankesë është nxjerrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji po nga vlerësimi i provave të lëndës, nuk ka gjetur prova sipas të cilave rezulton së ankuesi i është nënshtruar procedurës së gradimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 28 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, ku parashihet se: *Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës*, si dhe nenin 14 dhe Rregulloren Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku parashihet se: *Dhënia e gradave 1. Komisioni takohet sipas kërkesës së kryesuesit që të konfirmojë dhënien e gradave për anëtarët e rinj të shërbimit të karrierës, përfshirë Ambasadorët/Të ngarkuarit me punë/Shefat e Misionit, Zyrtarët diplomatikë dhe konsullorë, ashtu siç është përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse të Ministrisë për angazhim dhe rekrutim.*

Përmbledhur si me sipër, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.263/2022.

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së